

VENDIM
Nr. 249, datë 29.9.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “H&K@VALA MAR RESIDENCES” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016; dhe nenit 19, pika 1, germa “a” e rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1625/3 prot., datë 27.9.2022, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “H&K@Vala Mar Residences” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “H&K@Vala Mar Residences” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1555 prot., datë 19.9.2022, ka paraqitur aplikimin për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, nga ERE, në zbatim të aneksit A, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë tërësisht dokumentacionin e kërkuar nga rregullorja.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “H&K@Vala Mar Residences” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti